

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr.24, Datë 25.02.2026

PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT
DHE ADMINISTRATORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË “RAIFFEISEN
INVEST - SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.

Në mbështetje të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores nr. 1, datë 31.01.2024, “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të zj. Edlira Konini, në pozicionin e anëtares së Këshillit të Administrimit dhe Administratores së Përgjithshme të shoqërisë “Raiffeisen INVEST - shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a., deri më datë 02.02.2029.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Adela XHEMALI